

SHOQERIA "ELRODI - RAKS MUSIC" sh.p.k.
SELIA: Rr."Durrësit", pall.220, shk.2, ap.1/1, Tirane



V E N D I M N r . 3
I O R T A K U T E V E T E M T E S H O Q E R I S E M E P E R G J E G J E S I
T E K U F I Z U A R " E L R O D I M U S I C " s h . p . k .

Sot me date 30.06.2005 (dymije e pese), Ortaku i Vetem i Shoqerise "Elrodi Music" sh.p.k., z.Roland LLUPO, pasi shqyrtoi veprimtarine e shoqerise

K O N S T A T O I

Se me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.16799 date 23.01.1997, eshte regjistruar si person juridik Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ELRODI - RAKS MUSIC" sh.p.k. me Ortak te Vetem dhe Administrator z.Roland LLUPO ; Me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.16799/1 date 25.05.2004, ndryshohet emri i Shoqerise nga "ELRODI - RAKS MUSIC" sh.p.k. ne "Elrodi Music" sh.p.k.; me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane Nr.16799/2 date2005, eshte emeruar z.Flamur LALO ekspert per vleresimin e kapitaleve te shoqerise

Ortaku i Vetem pasi diskutoi raportin e ekspertit kontabel te autorizuar "Per vleresimin e kapitalit te shoqerise per vitin ushtrimor 2004 dhe ne baze te statutit te shoqerise "Elrodi Music" sh.p.k. dhe te neneve 60, 64 dhe 71 te Ligjit 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare",

V E N D O S I

1. Miratimin e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, zotit Flamur LALO, date 30.06.2005, caktuar per kryerjen e kesaj detyre me Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me Nr.16799/2 date _____.2005, "Per vleresimin e kapitalit themeltar te Shoqerise "Elrodi MUsc" sh.p.k. per vitin ushtrimor 2004."
2. Rrijen e kapitalit themeltar te Shoqerise "Elrodi Music" sh.p.k. ne vleren 2.000.000 (dymiljon) leke, nga vlere 100.000 (njqindmije) leke me nje shtese prej 1.900.000 (njemiljon e nenteqindmije).

O R T A K U I V E T E M

Roland LLUPO



**ORTAKUT TE VETEM
TE SHOQERISE "ELRODI MUZIC" SHPK
TIRANE**

**RAPORT
I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**

(Per rritjen e Kapitalit Themeltar te Shoqerise)

**EKSPERTI KONATBEL I AUTORIZUAR
Flamur LALO**

Tirane, me 30 Qershor 2005

R A P O R T
PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE
SHOQERISE "ELRODI MUZIC" SHPK

Une Flamur LALO, Ekspert Kontabel i Autorizuar me license nr.92 date 01.01.2001, me vendimin e Ortakut te vetem nr. 2 date 29.06.2005 jam caktuar te kryej ekspertimin e rritjes se kapitalit te shoqerise "Elrodi Muzic" shpk me seli ne Tirane.

Sipas Vendimit te Ortakut te Vetem nr. 3 date 30.06.2005, kapitali themeltar i shoqerise ndryshon nga 100.000 leke, ne 2.000.000 leke. Sipas ketij vendimi rritja e kapitalit do te realizohet nga fitimet e realizuara ne vite qe nga krijimi i shoqerise.

Une bera verifikimet e nevojshme duke kontrolluar fitimet e realizuara qe nga krijimi i shoqerise (periudha 1998-2004) dhe rezultoi si ne pasqyren e meposhtme:

Vitet Ushtrimore	Fitimet neto
1998	231.447
1999	217.887
2000	916.178
2001	1.167.738
2002	1.278.718
2003	1.310.416
2004	1.293.402
SHUMA	6.415.786

Fitimet e mesiperme jane reale dhe mbeshteten ne dokumente te ligjore sikurse jane bilancet e shoqerise dhe pasqyrat financiare. Keto bilance jane depozituar edhe ne organet tatimore dhe per fitimet e realizuara shoqeria ka paguar rregullisht tatim fitimin.

Por ne vendimin e ortakut te vetem behet fjale per shperndarjen e 5.815.786 leke. Diferenca midis fitimeve ne vite dhe shifres qe ka vendosur te shperndaje ortaku i vetem ne vendimin nr. 3 date 30.06.2005, ka te beje me nje shperndarje te meparshme qe ka bere ortaku i vetem ne vitin 2002. Ne kete vit, ortaku i vetem ka bere nje shperndarje prej 2.500.000 leke, nga te cilat 1.900.000 leke ne Kapitalin themeltar, 190.000 leke ne rezerva dhe 410.000 leke per t'i terhequr (duke i çuar ne llogarine 456 "ortake dividend



per t'u paguar"). Theksojme se per shumen e terhequr, ortaku i vetem ka paguar 41.000 leke tatim dividenti me MA e Bankes se Kursimeve nr. 327468 date 18.04.2003.

Duke qene se vendimi i mesiperm per rritjen e kapitalit nuk eshte depozituar ne gjykatën e Tiranës, ortaku i vetem e ka perseritur kete rritje ne vendimin nr.3 date 30.06.2005.

Sipas ketij vendimi (nr. 3 date 30.06.2005), ortaku ka vendosur gjithashtu qe 3.000.000 leke t'i terheqi per llogari te vet. Kujtojme se per kete vlere, brenda muajit Korrik shoqeria duhet te depozitoje ne zyren e tatimeve vendimin e ortakut te vetem. Ndersa brenda muajit Gusht 2005, shoqeria detyrohet te paguaje prane organeve tatimore 10% te kesaj shume si tatim ne burim.

Meqense regjistrimet e rritjes se kapitalit jane kryer qysh ne vitin 2002, per vendimin nr. 3 date 30.06.2005, ne kontabilitetin e shoqerise do te behen vetem regjistrimet e meposhtme:

Debi llog. "fitime te mbartura"	2.622.384 leke.
Debi llog. "fitime te ushtrimit"	877.616 leke.
Kredi llog. "Rezerva ligjore"	500.000 leke.
Kredi llog "Ortake dividend per t'u paguar"	2.700.000 leke.
Kredi llog. "shteti detyrime per tatim ne burim"	300.000 leke.

Mbas ketyre veprimeve kontabel, kapitalet e veta ne bilancin e shoqerise do te paraqiten si me poshte:

➤ Kapitali themeltar	2.000.000 leke.
➤ Rezerva ligjore	700.000 leke.
➤ Fitime te mbartura	415.786 leke.
Shuma	3.115.786 leke.

Ne perfundim une jap opinionin tim se rritja e kapitalit te shoqerise "Elrodi Muzic" shpk nga 100.000 leke ne 2.000.000 leke, eshte reale dhe e bazuar ligjerisht.

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Flamur LALO

Tirane, me 30 Qershor 2005


